

AKT THEMELIM-STATUT

(I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Sa.Ra Company" SH.P.K.)

Mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; në ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit", i ndryshuar me ligjin nr.9916, datë 12.05.2008; Ligjin nr.92/2012 dhe ligjin nr.8/2015, themelojmë sot në datë 10.08.2022 shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Sa.Ra Company" SH.P.K. me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

1. Themeluesi do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të quhet "Sa.Ra Company" SH.P.K.
2. Themeluesi është:
 - 2.1. Bledar Hibo banues në L15 Rr"Viktor Eftimiu" P49 H1 Ap1 Korce

Neni 2

Selia

1. Selia e shoqërisë do të jetë në adresen: L15 Rr"Viktor Eftimiu" P49 H1 Ap1 Korce . Me vendim të Ortakut të shoqërisë, selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu rast pas rasti, ajo mund të krijojë apo anullojë pika dytësore për aktivitetin që po ushtron, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë dhe vula

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe/ose në statutin e shoqërisë.
2. Me vendim të ortakut, shoqëria mund të vendosë kufizim kohor në veprimtarinë e saj, ose ta mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo janë rastet e parashikuara në ligj.

Neni 4

Organet drejtuese të shoqërisë

1. Organet drejtuese të shoqërisë janë: Ortaku i Shoqërisë, Administratori.
2. Administratori i kësaj shoqërie, është edhe themeluesi i saj, z. Bledar Hibo, për një periudhë 5 vjeçare.



Neni 5

Objekti

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
Tregëti me shumicë të artikujve kozmetikë.

Neni 6

Kontributi i ortakëve

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 5680 (pesëmijë gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë.
2. Ortaku zotërues i kapitalit ka 100% të kapitalit themeltar në vlerën 5680 lekë.

Neni 7

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar është depozituar prej shoqërisë në një llogari të hapur në emër të shoqërisë "Sa.Ra Company" SH.P.K. në formim e sipër.

Neni 8

Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë dhe është organi më i lartë drejtues që ushtron kompetencat e njohura në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".
2. Asambleja e Përgjithshme vendimet i merr sipas kuorumit të përcaktuar në bazë të statutit të kësaj shoqërie.

Neni 9

Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një person, i cili mund të jetë ose jo ortak i shoqërisë.
2. Administrator i shoqërisë është z. Bledar Hibo, me afat emërimi për 5 vjet, me të drejtë riemërimi.

Neni 10

Likuidimi

1. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas parashikimeve të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".



2. Gjatë procedit të likuidimit, Ortaku i Shoqërisë/Asambleja e Përgjithshme, emëron likuiduesin, i cili paraqet një raport mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e përfundimit të tyre dhe ndan aktivitetet e mbetura ndërmjet ortakëve, proporcionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e regjistruar.
3. Me përfundimin e procesit të likuidimit, ortaku i shoqërisë bën bilancin financiar përfundimtar për rregullshmërinë e likuiduesit, për heqjen e mandatit të tij si likuidator, si dhe mbylljen e procesit të likuidimit.

Neni 11
Çrregjistrimi

1. Shoqëria çrregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit pasi ka kryer të gjitha procedurat e likuidimit sipas ligjit.
2. Çrregjistrimi i shoqërisë bëhet:
 - 2.1 Vullnetarisht nga vetë shoqëria;
 - 2.2 Në bazë të një vendimi gjyqsor të formës së prerë;
 - 2.3 Sipas parashikimeve në ligj.

Neni 12
Rregullimi i shoqërisë

1. Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akti themelues, edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj dhe në dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe të Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit".
2. Ky akt Themelimi-Statut është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njëjtë ligjore. Një kopje dorëzohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe tjetra mbahet nga vetë Shoqëria.
3. Ky akt pasi u lexua dhe është konform vullnetit të ortakut, nënshkruhet prej tij me vullnet të lirë dhe të plotë.

ORTAKU I SHOQERISE
Bledar Hibo

